



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 12 QERSHOR 2024**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 12. JUNA 2024. GODINE**

**QERSHOR - JUN  
2024**

## **Rendi i ditës**

1. Shënimi i 25-vjetorit të Ditës së Çlirimit

## **Dnevni red**

1. Obeležavanje 25. godišnjice Dana Oslobođenje

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar qytetarë të Republikës sonë,  
E nderuara presidente e vendit, zonja Vjosa Osmani- Sadriu,  
I nderuari kryeministër Albin Kurti,  
I nderuari president i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj,  
Shumë i dashuri Baca Rifat Jashari,  
Shkëlqesia Juaj, Stipe Mesiq, për dhjetë vjet president i Kroacisë,  
E nderuara Shkëlqesia e Saj, zonja Calmy-Rey, ish-presidente e Federatës Zvicerane,  
E nderuara zonja Lindita Nikolla, kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,  
I nderuari Lordi Robertson, ish-Sekretar i aleancës më të fuqishme demokratike të botës,  
NATO,  
I nderuari zoti Graniq, ish-ministër i Kroacisë,  
I nderuari dhe shumë i dashuri ynë, William Walker, i cili gjatë luftës në Kosovë përfaqësoi misionin e OSBE-së dhe e shpërfaqti gjenocidin e Serbisë në Kosovë, të vërtetën për këtë gjenocid.  
Të nderuar të pranishëm,  
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara, Jef Hovenier,  
I nderuari Tomas Suniog, përfaqësues, ambasador i Bashkimit Evropian në Kosovë,  
Të nderuar shkëlqesi, ambasadorë të misionëve diplomatike që po ju shoh të pranishëm,  
I përshëndesim po ashtu me këtë rast të kësaj seance solemne edhe përfaqësuesit që po i shoh këtu të institucioneve tona më të rëndësishme, presidentin Sejdiu, zonjën Caka nga Gjykata Kushtetuese, përfaqësuesit e institucioneve tona të nderuara nga Forcat e Sigurisë së Kosovës, nga Agjencia e Inteligjencës, të gjithë ju që jeni të pranishëm.

Më lejoni që ta hap këtë seancë solemne me rastin e 25-të vjetorit të çlirimit të vendit tonë nga pushtimi serb. Ju lutem, qysh në fillim po ju kërkoj që të ngrihemi e ta respektojmë himnin tonë shtetëror dhe atë kombëtar.

*(Himni shtetëror dhe kombëtar)*

Tash, më lejoni që të ju kërkoj që ta mbajmë një minutë heshtje për të gjithë të rënë të kontribuuan në çlirimin e Kosovës.

*(Një minutë heshtje)*

Lavdi!

Po ia jap fjalën qysh në fillim presidentes së Republikës së Kosovës, zonjës Vjosa Osmani - Sadriu. Urdhëroni Presidente, fjala është e juaja!

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Shumë i nderuar president i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj,  
Kryetar i Kuvendit, z. Konjufca,  
Kryeministër i Republikës, z. Kurti,  
E nderuar kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Nikolla,  
E nderuar ish-presidente e Zvicrës, znj. Micheline Calmy-Rey,  
Ish-president i Kroacisë, z. Stjepan Mesiç,  
Shumë i nderuar Baca Rifat Jashari,  
Familje Jashari, emblemë e lirisë sonë,  
I nderuar Lord Robertson,  
I nderuar ambasador Walker,  
Deputetë e ministra të Republikës së Kosovës,  
Familje të dëshmorëve,  
Veteranë e invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,  
Të nderuara familje të dëshmorëve dhe atyre që dhanë shumë për lirinë tonë,  
Ambasadorë të shteteve mike,  
Mysafirë të nderuar,  
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Urime e gëzuar të gjithëve 25 vjet liri!

Më 12 qershor 1999, kur forcat e NATO-s shkelën në tokën tonë, ata nuk ishin vetëm ushtarë, ata ishin shpëtimtarë. Ata sollën me vete premtimin e lirisë, sigurinë se bota nuk kishte harruar për popullin e Kosovës dhe vendosmërinë për t'i dhënë fund mizorive të kryera kundër popullit tonë.

Hyrja e NATO-s në Kosovë në qershor 1999 ishte një dëshmi e fuqisë së solidaritetit ndërkombëtar dhe besimit të palëkundur në të drejtën universale të një populli për të qenë i lirë.

Liria është më shumë sesa fjalë, liria është vetë thelbi i qenies sonë. Është ajri që thithim, është ëndrra që guxam ta ëndërrojmë, është e ardhmja që aspiruam dhe për të cilën luftuan dhe e dhanë jetën çlirimtarët tanë. Çlirimi i Kosovës më 12 qershor 1999 nuk ishte thjesht një fitore ushtarake dhe një kapitullim i Serbisë milosheviqiane, ishte mbi të gjitha triumf i shpirtit njerëzor mbi tiraninë, ishte triumf i të mirës ndaj të keqes dhe i drejtësisë mbi shtypjen.

Kur paqeruajtësit e KFOR-it shkelën në tokën e Kosovës së përgjakur, të dërmuar, e të shkatërruar, atëherë lotët, britmat, lulet u shndërruan në përfaqime që i pritën ushtarët e NATO-s. Ato krijuan simfoninë e emocioneve të lirisë.

Kolonat e makinerisë ushtarake, zhurma e helikopterëve të NATO-s, uniformat me flamuj të shumtë, flamuj që simbolizonin lirinë e jo urrejtjen dhe dhunën, të gjitha këto u shndërruan në simbol të shpëtimit të popullit të Kosovës nga shfarosja nga regjimi gjenocidal i Serbisë, duke e larguar njëherë e përgjithmonë makinerinë gjenocidale të Milosheviqit, të turpëruar dhe të kapitulluar. E tillë mbetet ajo edhe sot.

NATO-ja në Kosovë ishte një dritë shprese - ishte një shans për drejtësi, një shans për liri!

Thirrjet e popullit tonë, persekutimi i pamëshirshëm dhe jetët e panumërta të humbura nga masakrat e tmerrshme, dëbimi me dhunë dhe spastrimi etnik ishin thirrje për drejtësi që nuk mund të shpërfillëshin më nga ndërgjegjja ndërkombëtare.

Prandaj, në qershor '99, muret e tiranisë u shembën, duke hapur rrugën jo vetëm për një Kosovë të lirë, por edhe të pavarur e demokratike.

Atë ditë, afro 38 mijë ushtarë nga 36 vende, komunikuan me gjuhën universale të lirisë. Atë ditë, siç thoshte filozofi dhe shkrimtari francez Andres Glucksman “Evropa lindi në një Prishtinë të lirë”. Sot mund të themi, Evropa lindi në një Kosovë të lirë.

Ndaj në këtë ditë, do ta kujtojmë përherë rezistencën këmbëngulëse të presidentit historik dr. Ibrahim Rugova për liri, pavarësi dhe demokraci, si dhe aleancat e fuqishme që ai ndërtoi së bashku me shumë e shumë veprimtarë të tjerë, e të cilat i gëzojmë edhe sot.

Do ta kujtojmë çdo ditë të jetës sonë, por edhe për brezat që vijnë pas nesh, heroizmin e papërsëritshëm të komandantit legjendar Adem Jashari dhe gjithë Familjes Jashari, të cilët u shndërruan gurthemelin e lirisë që gëzojmë sot.

Do të jetojmë përherë me kujtimin për të gjithë dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe mbi 13 mijë të vrarët gjatë luftës, në mesin e të cilëve 1 133 fëmijë të vrarë vetëm në luftën e fundit në Kosovë. Nuk do të harrojmë kurrë dhimbjen e shkaktuar nëpërmjet një prej krimeve më të llahtarshme që njih cilado luftë, krimin të dhunimit si dhe dhimbjen që ende vazhdon për mijëra familje në Kosovë që akoma nuk kanë ku të vendosin lule sepse varret janë të zbrazëta, në kërkim të të zhdukurve me dhunë gjatë luftës.

Të nderuar të pranishëm,

Sot qëndrojmë së bashku në tokën tonë, në tokën tonë të lirë, duke jetuar me historinë tonë të lavdishme, teksa kujtimet e dhimbshme të luftës, por edhe ndjenja e triumfit të lirisë janë në zemrën e secilit qytetar të Kosovës.

Prania e aleatëve dhe e paqeruajtësve ishte një dëshmi e përkushtimit të botës ndaj drejtësisë dhe dinjitetit njerëzor. Secili nga ta rrezikoi jetën duke lënë pas familjen dhe shtëpinë për të qëndruar me ne dhe me çlirimtarët tanë e me çdo qytetar të Kosovës në luftën tonë kundër shfarosjes. Në Kosovë, kërkimi për liri ka qenë një rrugëtim i gjatë dhe i mundimshëm. Në fakt, ishte shekullor. Jemi përballur me shumë vështirësi e vuajtje, por gjatë gjithë kësaj kohe ne kemi qëndruar të palëkundur në besimin se liria ia vlen me çdo sakrificë. Mbështetja e aleatëve ishte një pohim i fuqishëm i këtij besimi. Ajo na kujtoi neve dhe botës se liria është e drejtë, që edhe pasi të jetë arritur, duhet mbrojtur dhe ruajtur me çdo kusht e me çdo çmim. Kjo na kujton se aleanca dhe partneriteti me shtetet janë po aq determinuese për ta garantuar e mirëmbajtur lirinë e fituar, duke mos e marrë asnjëherë si të mirëqenë.

Prandaj, sot, teksa nderojmë ushtarët e NATO-s që kontribuan për lirinë tonë në këto 25 vjet, nderojmë mbi të gjitha stoicizmin e popullit tonë dhe ushtrinë tonë çlirimtare, me bindjen e plotë se liria nuk është dhuratë, por për të u pagua çmimi më i lartë që mund ta paguajë një popull. Liria edhe sot është përgjegjësi, është një trashëgimi që duhet ta mbrojmë dhe një premtim që duhet ta përmbushim për këtë gjeneratë dhe çdo gjeneratë që do të vijë pas nesh.

NATO në vitin 1999 na dha mbështetjen përfundimtare për lirinë tonë, andaj ne sot synojmë dhe e meritojmë anëtarësimin në këtë organizatë ushtarake, me ushtrinë tonë e cila me profesionalizmin e saj është e gatshme që të bëhet kontribuuese për paqe kudo në glob.

I nderuar president Begaj,

E dashur Lendita,

Shumë të nderuar miq e dashamirë, përkrahës nga e gjithë bota, e mbi të gjitha, nga të gjitha trojet shqiptare. Në këtë përvjetor të 25-të të çlirimit të Kosovës, ditë që e ëndërruan shqiptarët kudo që jetojnë, dhe jo vetëm që e ëndërruan, por për të cilën kontribuan e luftuan, shqiptarët nga Kosova, por edhe nga viset e tjera përreth Kosovës.

Dua ta përfundojë me një citat të shkrimtarit tonë të madh, Ismail Kadare, me fjalët që ai tha para pak muajsh kur i ndava medaljen presidenciale. Citoj: Vetë mbledhja jonë në këtë sallë, nga shqiptarë e miq të të gjitha zonave, e tregon këtë triumf të kombit shqiptar. Nga ky triumf, asnjë popull nuk heq dorë. Ky është një triumf për gëzimin dhe për të ardhmen e një populli. Prandaj, zonja e zotërinj, populli i Kosovës asnjëherë dhe me asnjë çmim nuk do të heqë dorë nga triumfi i lirisë.

Zoti i bekoftë heronjtë e martirët tanë!

Zoti i bekoftë miqtë e aleatët e Kosovës!

Zoti i bekoftë Kosovën dhe popullin e saj!

Ju faleminderit shumë!

Unë vetëm desha t'ju lus për mirëkuptim, meqenëse do të jem e pranishme në festën e madhe të forcave të NATO-s në Kosovë në orën 10:45 që t'i falënderoj ata në emër të popullit dhe të institucioneve të Kosovës. Më duhet të largohem nga salla, prandaj desha ta kërkoj mirëkuptimin tuaj!

Ju faleminderit dhe gëzuar Dita e Çlirimit!

**KRYETARI:** E falënderojmë Presidenten tonë. Tash më lejoni t'ju drejtohem me një fjalë rasti:

**KRYETARI GLAUK KONJUFCA:** E nderuar presidente e vendit Vjosa Osmani-Sadriu, I nderuar kryeministër Kurti, Të dashur miq që na keni nderuar me praninë tuaj sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në këtë ditë vërtet të rëndësishme për ne, Baca Rifat, President Begaj, Presidente Calmy Rey, President Mesiq, I nderuar Lordi Robertson, I nderuar ambasador, zoti Walker, Të nderuara zonja e zotërinj, Të nderuar të pranishëm, 12 Qershori i vitit 1999 është dita e rikthimit të shpresës për popullin e Kosovës. Pas gati një shekulli nën sundimin serb, Kosova u çlirua. Të shumta janë padrejtësitë, diskriminimet, segregimet, keqtrajtimet, burgosjet e krimet që u ushtruan mbi popullin shqiptar nga regjimet okupuese të Serbisë. Të panumërta janë viktimat shqiptare të këtyre regjimeve që u mbështetën në programet sistematike historike e politike, të shtetit serb, që e kishin vetëm një synim, e ky ishte shfarosja e një populli të tërë nga territori dhe përmes krimeve të llahtarshme.

Këto krime të Serbisë e morën përmasën e gjenocidit. Për ne Serbia mbeti e njëjtë, pavarësisht a u quajt dikur "Mbretëri Jugosllave", a u quajt pastaj Jugosllavi federative a socialiste. Politika e shtypjes, e dëbimit, e shpronësimeve, e diskriminimit dhe e nënçmimit ka qenë tipari konstant i secilit prej këtyre regjimeve.

Kur e kremtojmë 12 Qershorin, Ditën e Çlirimit të Kosovës, e kemi domosdoshmëri etike që të reflektojmë mbi historinë, se ajo për popullin tonë ka qenë vërtetë e vështirë.

Prandaj, ta kujtojmë të shkuarën e të mos e harrojmë të vërtetën, nuk do të thotë të mos e duam paqen edhe pajtimin. Por ne, gjithmonë e shohim pajtimin vetëm si rezultat të drejtësisë. Ne kujtojmë dhe do të kujtojmë gjithmonë, sepse duam që padrejtësia dhe pushtimi të mos përsëriten kurrë më. 12 Qershorin do ta festojmë përherë si ngadhënjim mbi të keqen, si ditë të fitores së drejtësisë mbi padrejtësinë, të lirisë mbi robërinë, të çlirimit mbi shtypjen dhe të humanizmit mbi fashizmin.

Më lejoni që në këtë seancë solemne po ashtu të shpreh nderim me përvullësi ndaj të gjithë heronjve dhe dëshmorëve të rënë për çlirimin e Kosovës, për lirinë dhe dinjitetin e popullit të Kosovës. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në krye me komandantin legjendar Adem Jashari do të mbetet kapitulli më i lavdishëm i historisë sonë të re. Populli ynë edhe pse i dërrmuar nga pushtimi i gjatë e i egër, arriti që nga gjiri i vet t'i jepte atdheut djemtë dhe vajzat e veta më të mira, gjaku i të cilëve është gur themel i lirisë dhe i pavarësisë sonë.

Një popull që mbijetoi, rezistoi e luftoi, si dëshmi e të drejtës për të qenë i lirë në tokën e vet shekullore, nuk kishte edhe se si të mos e arrinte ndihmën nga aleanca më e fuqishme euro-perëndimore e demokratike, e cila atëbotë, para gjysmë shekulli e kishte çrrënjësuar edhe fashizmin në kontinentin evropian, ndërsa atëbotë, përpara një dekade kishte triumfuar edhe mbi totalitarizmin sovjetik.

Intervenimi i NATO-s në Kosovë, duke e bombarduar ish-Jugosllavinë e Millosheviqit, përveçse intervenim humanitar për ta shpëtuar një popull, të cilit po i kanosej zhdukja përmes gjenocidit, ishte përmbyllje e një shekulli të triumfit të lirisë nga forcat demokratike të botës, e fitores së demokracisë dhe vetëvendosjes së popujve mbi ideologjinë fashiste, totalitariste dhe hegjemoniste. Mirënjohja jonë do të jetë e përjetshme për miqtë tanë më të rëndësishëm që na ndihmuan, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Francën, Italinë, shtetet e rëndësishme të Bashkimit Evropian dhe pjesëtarët e aleancës veri-atlantike. Ne do të jemi edhe si deputetë, edhe si popull përherë mirënjohës.

Lavdi të gjithë të rënëve për çlirimin dhe lirinë e Kosovës!

Nderim për veprën dhe sakrificën e të gjithë atyre që mundësuan që ne sot ta kremtojmë këtë ditë të lavdishme! Ju faleminderit!



KRYETARI: Tash, ia jap fjalën që t'i drejtohet kësaj seance kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Albin Kurti.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Shkëlqesia Juaj, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës,

Shkëlqesia Juaj, z. Bajram Begaj, president i Republikës së Shqipërisë,

I nderuari kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca,

E nderuara kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonja. Lendita Nikolla,

I nderuari Lord George Robertson, ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s,

Shkëlqesia Juaj, z. Stjepan Mesiç, ish-president i Republikës së Kroacisë,

Shkëlqesia Juaj, zonja. Micheline Calmy-Rey, ish-presidente e Konfederatës së Zvicrës,

Shkëlqesia Juaj, z. Mate Graniç, ish-ministër i Punëve të Jashtme dhe i Çështjeve

Evropiane i Republikës së Kroacisë,

I nderuari ambasador William Walker, ish-udhëheqës i misionit të OSBE-së në Kosovë,

I nderuari Baca Rifat Jashari,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,

Zëvendëskryeministra e ministra të Qeverisë,

I nderuari komandat i ushtrisë sonë, gjenerallejtënant Bashkim Jashari,

Shkëlqesi ambasadorë dhe miq e mysafirë ndërkombëtarë,

Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë e veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Të nderuar udhëheqës e përfaqësues të institucioneve shtetërore, kryetarë të komunave,

Të nderuar prijës fetarë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar të pranishëm,

Në rrjedhën e pandërprerë të kohës si përditshmëri, vijnë disa ditë të veçanta, sikur dita e sotme, kur është shumë e rëndësishme të përqendrohemi në të tashmen për të reflektuar mbi rrugën që e kemi kaluar deri këtu. Të bashkohemi fizikisht e shpirtërisht siç jemi bashkuar sot këtu në Kuvendin e Republikës, dhe më pas në sheshet e qyteteve mes qytetarëve tanë, për ta shënuar një ngjarje historike që na e ka sjellë të tashmen dhe na e ka përcaktuar të ardhmen. Sot, është pikërisht një nga ato ditë, meqë është Dita e Çlirimit të Kosovës.

12 Qershori 1999 është fiksuar si Dita e Çlirimit të Kosovës, sepse atë ditë, dhjetëra mijëra trupa ushtarake të NATO-s, filluan ta kalojnë kufirin dhe të futën si trupa këmbësorie në territorin e Kosovës. Kjo erdhi pas një fushate 78-ditore të bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavi, në përpjekje për ta ndaluar spastrimin etnik dhe gjenocidin që shteti serb po e kryente mbi shqiptarët në Kosovë. Por, vetëm disa orë më herët, befasisht dhe tradhtisht, një kontingjent prej rreth 200 ushtarësh rusë i shkëputur nga misioni SFOR në Bosnjë-Hercegovinë, kishte arritur në mesnatë në qendër të Prishtinës.

Kështu, ndërmjet 11 dhe 12 qershorit 1999, Kosova dhe veçanërisht zona e Prishtinës, u bë arenë zhvillimesh që morën vëmendje globale. Në njëren pjesë të qytetit, forcat ushtarake dhe policore serbe dhe jugosllave ende nuk ishin tërhequr plotësisht nga Prishtina; në pjesën tjetër, në verilindje të Prishtinës, njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Zona Operative e Llapit, kishin hyrë në qytet duke e ngritur flamurin kombëtar shqiptar në shkollën “Zenel Hajdini” dhe në rrugën e Bledit; më tej, pasi kishin kaluar nëpër Prishtinë, trupat ruse shkuan dhe u stacionuan në Aeroportin e Prishtinës në Sllatinë, duke e pushtuar dhe bllokuar atë; ndërkohë, mijëra ushtarë britanikë po përparonin drejt Prishtinës. Përbalje mes palëve, çfarëdo trajte që mund të merrte, dukej e pashmangshme.

Skenarët eventuale të asaj situate, ishin sa të paparashikueshëm aq edhe të frikshëm. Nga rreziku i dështimit të zbatimit të Marrëveshjes së Kumanovës, që parashihte tërheqjen e të gjitha forcave të armatosura jugosllave e serbe nga Kosova para 20 qershorit, por që nuk parashihte asnjë involvim trupash ruse, dhe deri te një përplasje luftarake që mund të kishte trajtën e një lloj Luftë të Tretë Botërore, e thënë kjo kushtimisht. Dukej sikur zaret tashmë ishin hedhur, por NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk po luanin me zare. Si Komandanti i NATO-s, Gjenerali amerikan Wesley Clark, ashtu edhe Komandanti i KFOR-it, Gjenerali britanik Michael Jackson, ishin të vendosur ta realizonin në plotëni misionin e marrë përsipër nga drejtuesit politikë të NATO-s, nga Presidenti amerikan, Bill Clinton dhe nga Kryeministri britanik, Tony Blair. Përtej teknikaliteteve ushtarake dhe të së drejtës ndërkombëtare, rezultati de facto i atij misioni ishte çlirimi i Kosovës nga trupat serbe.

Detajet e mëtutjeshme dhe faktet e regjistruara të ngjarjeve të atyre ditëve, i takojnë historisë dhe historianëve. Por pikërisht nga kjo histori duhen nxjerrë mësimet, siç edhe kemi bërë nga atëherë e deri më sot. Dhe kjo kuptohet më së miri nga rreshtimi gjeopolitik dhe gjeostrategjik i vendeve tona sot. Sikur atëherë edhe tani, Serbia rri e rreshtuar prapa Rusisë, ashtu siç Rusia qëndron prapa shumë veprimeve të Serbisë. Kurse shteti ynë Kosova, dhe populli i saj bashkë me Shqipërinë, në vazhdimësi ka shkuar duke i forcuar lidhjet dhe aleancën e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Britaninë e Madhe, me Gjermaninë dhe Turqinë, me Francën dhe Italinë dhe me vendet e tjera partnere perëndimore. Bashkimi Evropian është familja jonë e synuar politike, kurse NATO-ja është destinimi ynë ushtarak.

Andaj sot po e shënojmë 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës, duke qëndruar bashkë me aleatët tanë, njësoj si më 12 qershor dhe njësoj si në ditët e para të çlirimit. Që nga fillimi i vitit 2023 dhe deri në mes të këtij viti, ditë pas dite, për aq sa ka zgjatur lufta e Kosovës, i kemi përkujtuar në 25-vjetorët e tyre dëshmorët e luftëtarët e lirisë dhe betejat e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; i kemi përkujtuar të vrarët dhe viktimat e

gjithë atyre masakrave; i kemi përkujtuar të zhdukurit me dhunë, viktimat e përdhunimit e torturës, të burgosurit dhe pengjet e luftës; i kemi kujtuar dëmet dhe shkatërrimet, plaçkitjet dhe djegiet; i kemi përkujtuar dhe denoncuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, spastrimin etnik dhe gjenocidin që Serbia e kreu në Kosovë.

Pikërisht pse kemi vuajtur dhe humbur kaq shumë, tash ne duam që në Republikën demokratike të Kosovës të gjithë qytetarët të gëzojnë e të fitojnë, shumica shqiptare bashkë me pakicat serbe, boshnjake, turke, me ashkalinjtë, romët, egjiptianët, por edhe me kroatët e malazezët. Duan marrëdhënie të mira fqinjësore evropiane, me njohje reciproke e bashkëpunim të shumanshëm në gjithë rajonin tonë, pa sulme dhe agresione, pa diskriminime e shfrytëzime.

Sot, me vetëdijen më të lartë politike dhe me kujtesën më të kthjelltë kolektive, po e kujtojmë 12 qershorin e vitit 1999, Ditën e Çlirimit të Kosovës.

Nga ajo ditë dhe deri sot, janë mbushur gjithsej 25 vite, pra një epokë prej një çerekshekulli në historinë moderne të Kosovës, të një kohe gjatë të cilës populli i Kosovës ka jetuar në liri më shumë dhe më cilësisht se sa në cilëndo epokë tjetër historike. Kurrë më të lirë dhe më të pavarur nuk kemi qenë dhe kurrë më të vendosur se sot nuk kemi qenë për ta mbrojtur lirinë dhe pavarësinë tonë: me çdo kusht, me gjithçka, me çdo gjë, çdonjëri.

Urime 25-vjetori i çlirimit të Kosovës! Nderime dhe mirënjohje e thellë secilit person dhe grup të çdo gjenerate, secilës organizatë dhe secilit luftëtar; secilit shtet dhe aleat, që ndër dekada kanë kontribuar për Ditën e Çlirimit të Kosovës më 12 qershor 1999 dhe për popullin e saj, për të ardhmen tonë të përbashkët kombëtare, evropiane, dhe progresiste, për liri dhe paqe, për Republikën e Kosovës, për sot, për jetë e mot.

Gëzuar e ju faleminderit!

**KRYETARI:** E falënderojmë kryeministrin për fjalën e tij. Tash, fjalën po ia japim presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Bajram Begaj. Urdhëroni, zoti Begaj!

**PRESIDENTI I SHQIPËRISË, BAJRAM BEGAJ:** Përshëndetje,

Gëzuar 12 Qershori!

E nderuara zonja presidente, zonja Osmani,

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca,

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Kurti,

E nderuar kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, zonja Nikolla,

Të dashur miq të Kosovës dhe të shqiptarëve,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,  
Të nderuar ambasadorë e pjesëmarrës,  
Të dashur bashkatdhetarë, motra dhe vëllezër,  
I dashur Baca Rifat,  
Në përvjetorë të tillë të shenjtë për shqiptarët ne përulemi me nderim para martirëve dhe figurave të shquara që, me jetën dhe veprën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, lanë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën dhe historinë e kombit shqiptar.

Sot nderojmë Ibrahim Rugovën, arkitektin e Pavarësisë së përhershme të Kosovës, simbolin e rezistencës paqësore, elitës intelektuale, që me filozofinë e tij të paqes vendosi çështjen e Kosovës në të gjitha kancelaritë perëndimore.

Sot nderojmë Adem Demaçin, veprimtarin qëndrestar të çështjes kombëtare, i palodhur në betejën e tij për mbi pesë dekada, sfiduesin lapidar të 28 vjetëve në burgjet e ish-Jugosllavisë.

Sot përulemi përpara Jasharëve, familjes simbol të martirizimit për Kosovën e pavarur, flakadanë të lirisë së saj.

Nderojmë kryetrimin Adem Jashari, legjendë e gjallë e atdhedashurisë. Burra të tillë rrallë i lind historia.

Sot është dita të kujtojmë të gjithë luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ata që i falën Kosovës së lirë e të pavarur jetën dhe ata që amanetin e bashkëluftëtarëve ua transmetuan brezave të rinj: Liria nuk është dhuratë. Ajo duhet të mbrohet!

Të dashur bashkatdhetarë, Kosova nuk ishte vetëm, qindra vëllezër të tyre nga: Tirana, Tropoja, Kukësi, Kruma, Kavaja, Vlora, Berati, Tepelena, Çamëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe nga e gjithë Diaspora shqiptare iu bashkuan luftës. Në themelet e lirisë së Kosovës, ata u flijuan, si Ushtar Kavaja, Komandant Shpendi, Komandant Tahiri, trima që nuk iu frikësuan vdekjes. Shqipëria hapi zemrën dhe dyert e shtëpive për të mbrojtur vëllezërit e motrat nga Kosova, të dëbuar me forcë si pasojë e valës së spastrimit etnik e gjenocidit të Milosheviqit.

Kosova nuk ishte vetëm!

Bashkësia Ndërkombëtare, veçanërisht partnerët strategjikë, si: Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Bashkimi Evropian dhe NATO ishin mbështetësit e fuqishëm e të palëkundur të kauzës së saj. Ndërhyrja e tyre ndaloi spastrimin etnik, gjenocidin dhe i dha

të drejtë shpirtit të një populli qëndrestar që kërkonte një të drejtë të mohuar; lirinë. Ata ishin hartuesit dhe zbatuesit e projektit të shtet formimit të Kosovës.

Të dashur vëllezër dhe motra,

Dy shtete, një popull, një komb, një gjak, një gjuhë, një shqiptarë dykrenare, një histori, një ëndërr dhe aspiratë euroatlantike. Historia e vjetër dhe e re ka dëshmuar se shqiptarët, kudo që ndodhen, përbashkohen nën simbolet e tyre identifikuese e kombëtare. Në sfidat e kohërave, epokave dhe padrejtësive gjeopolitike, shqiptarët kanë ruajtur të shenjtë dhe të pacenueshme ndjenjën e shqiptarisë. Shqiptarët kanë nevojë për të ruajtur dhe forcuar kohezionin e tyre kombëtar dhe socio-kulturor edhe sot.

Në një kohë kur Serbia dhe aleatët e saj kanë mobilizuar kapacitete diplomatike, mediatike, në një fushatë thellësisht keqdashëse për të njollosur luftën e drejtë e parimore të shqiptarëve për çlirimin e Kosovës, ne kemi nevojë më shumë se kurrë të jemi bashkë, ne kemi nevojë më shumë se kurrë për një manifest krenarie kombëtare, që nuk ka pse të na kompleksojë. Nuk mund të lejojmë të vendoset shenja e barazimit mes krimit të programuar serb dhe luftës për dinjitet, mbijetesë e liri të shqiptarëve në Kosovë. Nuk mund të lejojmë që krimi të shfaqet si virtyt, në një kohë kur bota demokratike, miqtë tanë, po bëjnë çmos të eliminojnë pengesat e ndryshme për të thjeshtëzuar bashkëjetesën shqiptaro-serbe sipas modeleve evropiane.

Historia na njeh ne shqiptarët si paqedashës, që e duam dhe e çmojmë fort lirinë. Si të tillë, ne sot kemi përgjegjësi të madhe për të ruajtur dhe forcuar paqen, sigurinë dhe zhvillimin në një hapësirë që frymon vlerat demokratike evropiane. Aspiratat tona për integrimin euroatlantik të faktorit shqiptar janë më të forta se kurrë, dhe ne do të vazhdojmë të punojmë pa u lodhur për të realizuar këtë objektiv.

Motra e vëllezër të dashur,

Sot ne përballemi ende me përpjekje për të penguar shtetin e ri të Kosovës, që lufton për të konsoliduar identitetin shtetëror, hapësirën dhe vendin e vet në Evropë. Jemi të vetëdijshëm se kauza e Kosovës nuk ka përfunduar, por jemi të palëkundur në bindjen tonë se realiteti, Republika e Kosovës, e pavarur dhe sovranë, është e padiskutueshme dhe e patjetërsueshme. Shteti shqiptar e ndien detyrë dhe mision të mbështesë çdo përpjekje të Qeverisë së Kosovës, të institucioneve të saj për të faktorizuar Republikën e Kosovës si shtet që respekton të drejtat dhe liritë e njeriut, i qëndron frymës Euroatlantike, që mban e trashëgon miqësitë që na janë gjendur në ditët tona më të errëta, duke besuar, duke dëgjuar, duke ndjekur e këshilluar nga partnerët strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-ja.

Shqipëria ka punuar dhe do të punojë për t'i shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e veta dhe hapësirat institucionale ndërkombëtare ku bën pjesë. Për të zgjeruar numrin e vendeve për njohjen e shtetit të Kosovës dhe integrimin tij në organizmat ndërkombëtarë, si dhe për të zbuluar të gjithë të vërtetën, ende të panjohur, të krimeve dhe gjenocidit të bërë në Kosovë, të atyre mijëra viktimave të torturuar e të zhdukur, dhunimeve e masakrave të pangjara në historinë moderne të njerëzimit.

Shpreh bindjen se të përlurur para sakrificës së dëshmorëve, të përgjegjshëm para historisë dhe guximtarë përpara së ardhmes, Kosova do të ndërtojë një shoqëri ku të mbizotërojë paqja dhe prosperiteti.

Kosova nuk është vetëm. Kosova nuk do të jetë vetëm.

Kosova është histori suksesi.

Çdo betejë juaja, është beteja jonë! Çdo sukses juaji, është sukses i gjithë shqiptarisë!

Gëzuar Ditën e Çlirimit!

**KRYETARI:** Falënderojmë presidentin Begaj, dhe njëkohësisht shfrytëzoj rastin ta lirojmë presidenten Vjosa Osmani-Sadriu për shkak të aktivitetit që e ka me trupat e NATO-s. Faleminderit, Presidente!

Tash po ju them që falë kontributit të saj të jashtëzakonshëm, ne kemi një bashkëpunimin të shkëlqyeshëm me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Sot na ka nderuar me praninë e saj, kryetarja Nikolla. Kryetare, faleminderit! Fjala është e juaja.

**KRYETRJA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË, LINDITA NIKOLLA:** Të dashura motra dhe vëllezër të Kosovës!

I nderuar president i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Beqaj,

I nderuar kryetar i Kuvendit, z. Glauk Konjufca,

I nderuar kryeministër, z. Albin Kurti,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

I dashur Baca Rifat,

Të nderuar miq të ftuar të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

25 vjet në historinë e një shteti nuk janë pak.

Por, një çerek shekulli të Republikës së një populli për të cilin shteti ka qenë një planet i largët, janë domethënëse.

Çlirimi i Kosovës është vepër e popullit të Kosovës, i cili besoi dhe mbështeti, në një betejë të gjatë e të pamposhtur luftëtarët e tij të ideve dhe të paqes, simboli i të cilëve u bë Presidenti Rugova.

Çlirimi i Kosovës është vepër e popullit të Kosovës, i cili besoi, mbështeti, luftoi bashkërisht dhe shndërroi në kauzë të vet luftën çlirimtare të luftëtarëve të luftës, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, simbol i të cilëve u bë Adem Jashari dhe mijëra dëshmorë që u flijuan në luftën për çlirimin e Kosovës.

Rezistenca dhe lufta çlirimtare e Kosovës ndau një shekull, ndau një mijëvjeçar dhe zgjidhi një dilemë të botës së qytetëruar, një çështje të madhe për moralin evropian dhe botëror: Do të vijojmë të tolerojmë shtypjen e egër dhe brutale ndaj një populli mu në mes të kontinentit evropian? Apo do ta ndihmojmë këtë popull të realizojë aspiratat e tij për t'u bërë i lirë dhe sovran në tokën e vet, në shtetin që i mungon?

Kosova, Shqipëria dhe kombi shqiptar kemi qenë shpesh të rrezikuar. Ekzistencën, territorin, gjuhën dhe identitetin na e kanë vendosur shpesh në pikëpyetje e rrezik.

Por ne kemi mbijetuar gjithmonë, në të gjitha udhëkryqet e historisë. Nga Prizreni e Vlora, Tirana e Prishtina, Korça e Presheva shqiptarët nuk i ikën kurrë nderit dhe detyrave që u dha emri shqiptar.

U bëmë qytetarë të denjë të qytetërimit që i përkasim nga rrënjët, identiteti dhe aspiratat, pa dallim feje, krahine e ideje, dhe iu falëm vetëm flamurit kombëtar.

Në agimin e shekullit dhe mijëvjeçarit të ri, Kosova u çlirua. Ky çlirim erdhi nga bijtë e saj. Ky çlirim ndodhi pasi ndërjegjja, vullneti dhe aksioni i botës së lirë iu bashkua qëndresës për vite e dekada paqësore e më vonë edhe luftarake të një populli të etur për liri, shtet, vlera demokratike, paqe e progres shoqëror.

Kosova e lirë dhe e pavarur është rezultat i vullnetit, mbështetjes dhe veprimeve të aleatëve tanë të mëdhenj dhe partnerëve strategjikë të shqiptarëve, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Gjatë këtyre 25 vjetëve, Kosova, më e reja Republikë e Evropës, po ndërtohet si një shtet modern dhe euroatlantik, në vizion, vlera, institucione, qëndrime e partneritete.

Lufta për çlirimin e Kosovës u fitua me ndihmën e aleatëve e partnerëve, miqve të çmuar të kombit shqiptar.

Kosova e zhvilluar, demokratike dhe paqësore do të vijojë të ndërtohet po me ndihmën e miqve dhe aleatëve tanë të mëdhenj.

Me mbështetjen e tyre, e ardhmja euroatlantike e Kosovës është e sigurt. Pa ndihmën e tyre asgjë nuk është e garantuar.

Shqipëria e Kosova janë sot dy shtete të pavarura, me miq e aleatë të mëdhenj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, NATO-n dhe botën e qytetëruar, dhe që aspirojmë anëtarësimin në familjen evropiane.

Shqipëria mbështet fuqimisht zhvillimin, demokratizimin, shtimin e njohjeve dhe fuqizimin e rolit ndërkombëtar të Kosovës. Çdo sukses i Kosovës është edhe i Shqipërisë. Çdo sukses i Shqipërisë është edhe i Kosovës.

Kuvendi i Shqipërisë dhe Kuvendi i Kosovës po vijojnë partneritetin e ngushtë dhe bashkëpunimin intensiv, mbështesin bashkëpunimin mes qeverive dhe institucioneve, në të mirë të shqiptarëve dhe paqes në rajon.

Gëzuar, Kosovë, 25-vjetorin e çlirimit!

Lavdi dëshmorëve dhe luftëtarëve të lirisë! Faleminderit!

**KRYETARI:** E falënderojmë të gjithë së bashku kryetaren Nikolla! Tash po ia jap fjalën atij, i cili si president ia shpalli vdekjen Jugosllavisë, presidentin kroat gjatë viteve 2000-2010, Shkëlqesinë e Tij, Stipe Mesiq. Faleminderit, president Mesiq!

Përndryshe, për të gjithë ata që nuk e dinë, sivjet i bën 90 vjet.

**STJEPAN MESIĆ:** Vaša ekscelencijo,

Dame i gospodo,

Dragi prijatelji,

Iza nas su nedavno održani evropski izbori, Evropska unija je naš zajednički dom. NATO je naš zajednički sigurnosno ekonomski kišobran, upravo to naglašavamo ovde u Prištini, u Republici Kosovo, obeležavajući 25. godina od oslobođenja Kosova.

Prvenstveno zahvaljujući Oslobodilačkoj vojsci Kosova. UČK uz pomoć Međunarodne zajednice posebno NATO saveza i Sjedinjenih Američkih Država. Na Kosovu je sprečen masovan zločin zahvaljujući međunarodnoj zajednici, NATO savezu i kasnije raspoređivanju NATO-vih postroji na teritoriji Kosova.



Iako smo mislili da je najteže razdoblje iza nas, nažalost potreba za delovanje i prisutnošću međunarodne zajednice u regiji još uvek postoji, ne samo na Kosovu, nego i u Bosni i Hercegovini.

Još uvek moramo biti spremni da se suočimo sa novim izazovom, u stvari starim izazovima koji su redizajnirani u nove.

Mogu slobodno reći da je arhitektura granica u regiji završena proglašenjem nezavisnosti Republike Kosovo.

Na žalost još uvek postoje pretnje i opasnosti od takozvanih veliko državnih projekata.

Mir i stabilnost moraju biti naša svetinja koji moraju osigurati prosperitet svih nas.

Najbolji odgovor za sve izazove i pretnje je Euroatlanstka perspektiva zemalja regije.

Vesele me uspesi Kosova, pre 25 godina proterano je stotine tisuća kosovskih Albanaca sa jasnom namjerom potpunog etničkog čišćenja.

Veliko državni projekt srbijanskog režima je poražen upravo na Kosovu. U susjedstvu Kosova imamo pozitivan primer Severne Makedonije koja je uspela napraviti povjesni iskorak u stabilizaciji te zemlje i postati punopravna članica NATO saveza. Pri tome je iznimno značajnu ulogu odigrao i Albanski politički faktor, koji je državotvorni faktor u toj zemlji.

Početak pregovora sa Evropskom unijom, Albanije i Severne Makedonije je snažan poticaj i za Kosovo. Veseli me da Kosovo ima jake, snažne, hrabre, mlade i odlučne lidere koji su spremni neobično raditi za dobrobit svih svojih građana.

Kosovo je nesporno čimbenik mira i stabilnosti i vjerujem da će Kosovo napredovati mnogo brže nego što je to slučaj na drugim državama regije.

Kosovo ima mlado stanovništvo i brojnu i školovanu dijasporu koja se za razliku od drugih zemalja regije u značajnoj meri vraća na Kosovo i uključuje u izgradnji svoje zemlje.

Građani su svugdje često nezadovoljni i mnogo čemu su u pravu, jer se vjerovatno može učiniti mnogo više. Tako je i u mojoj zemlji, Hrvatskoj, mnogo je nezadovoljstva, jer su očekivanja od svojih političkih elita mnogo veća.

Mislim da su tome uglavnom u pravu , jer nositelji najvećih državnih funkcija moraju biti potpuno posvećeni i biti u funkciji svojih građana i države.

Duboko sam uvjeren da će se mnogo toga promeniti ulaskom Kosova u Evropsku uniju i NATO savez, jer mogu svjedočiti što znači ulazak u Evropsku uniju i NATO savez za moju zemlju i šta je dobrog napravljeno.

Putem sredstava iz euro fondova, Hrvatska se gospodarski brzo razvija, dok je članstvo u NATO privukao domaće i strane investitore. Pravi učinci članstva u Evropskoj uniji i NATO u Hrvatskoj tek se očekuju, međutim ne smemo zaboraviti da iznutra gradimo zdravo društvo. Pokazatelji dostignuća u brojnom su jasni ali uvek čovek, ljudi, njihova duša su nešto posebno i tu moramo pokazati senzibilitet prema običnom čoveku.

Zadovoljan građanin mora biti mjera našeg uspeha. Radimo privrženi ujedinjenu Evropske unije kao kontinentu trajnog mira i dugoročne stabilnosti.

Rat u Ukrajini nam je pokazao koliko je krhak i važan mir u Evropi.

Želim da među nama nestanu mentalne i fizičke granice, da unapređujemo naše međusobne odnose za sveopći napredak i boljitak svih zemalja, posebno naše regije.

Uvjeren sam da Republika Kosovo gradi intenzivno društvo, jednako za sve njene građane, bez obzira na etničko i svako drugo opredeljenje.

Pojedinačni uspeh u regiji je uspeh svih nas , jer samo kroz suradnju, dijalog razumevanje međusobno poverenje i potporu možemo osigurati bolju i izvesniju budućnost.

Neka nam putokaz za budućnost budu, tri reči: mir, stabilnost i prosperitet.

Na kraju neka živi slobodno, napredno, suvereno i vječno Kosovo. Hvala vam ljepo!

**KRYETARI:** Tash po kalojmë te grupet tona parlamentare që i kemi të përfaqësuar në Kuvend. Fjalën po ia japim fillimisht Grupit të Vetëvendosjes, nënkryetarja Saranda Bogujevci, e cila ka lindur pikërisht më 12 qershor. Urime çlirimi, Saranda, dhe urime ditëlindja njëkohësisht!

**SARANDA BOGUJEVC:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar president Begaj,

I nderuar Baca Rifat,

I nderuar zoti Robertson,

I nderuar ish-president Mesiq,  
I nderuar ambasador Walker,  
E nderuar kryetare Nikolla,  
E nderuar ish-presidente e Federatës Zvicerane, zonja Calmy-Rey,  
I nderuar zoti Graniq,  
Të nderuar dhe të dashur qytetarë,  
Familjarë të dëshmorëve,  
Veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,  
Diplomatë dhe ambasadorë që u kemi të pranishëm sot këtu në Kosovë,  
Është ditë goxha emocionues për mua,

Si sot, para 25 vjetëve isha e shtrirë në Spitalin e Prishtinës.

Aty isha së bashku me fëmijët e axhës, Gencin, Fatosi, Jehonën dhe Lirien të cilën e patën dërguar në Beograd. Që të gjithë të plagosur rëndë.

Ditë me parë, domethënë, para 12 qershorit të vitit 1999, qe zbrazë nga shumica e mjekëve dhe motrave medicinale spitali, pati mbetur vetëm një pjesë e vogël që qëndruan, dhe në ato momente morëm lajmin që kanë hyrë forcat e NATO-s.

E kam kujtesën shumë të freskët nga ajo kohë. Dhe, më kujtohet që një natë më parë ishte një errësirë, dëgjoheshin të shtëna, por e ndjeva një qetësi shpirtërore dhe në atë kohë e mendoja që edhe nëse ndodh diçka e keqe, unë nuk do të trembesha.

Në po këtë ditë dhe në atë kohë i pata mbushur 14 vjet. Vajza e axhës, Jehona 11 vjet, Liria 9 vjet, që të tria ndajmë të njëjtën ditëlindje.

Dhe sot është ndjenjë krenarie çdo ditëlindje kur feston me popullin tënd, me qytetarët e vendit tënd, këtë ditë të madhe të çlirimit. Ne e paguam shtrenjtë lirinë tonë. Jo vetëm me luftën e fundit, por me dekada e gjenerata.

Këto pasoja e kujtime të hidhura të kësaj mizorie, të këtij gjenocidi i shohim e përjetojmë edhe sot. Fatkeqësisht, ende sot Serbia që nuk ndien as keqardhjen më të vogël të krimeve qe i ka bërë, na krijon pengesa e beteja të vazhdueshme, duke mos na lënë për t'i shëruar plagët.

Por, ne sot e përgjithmonë do ta mbajmë mend këtë ditë me gjithë kujtimet, përherë do ta festojmë, të gjithë së bashku, me miqtë tanë që na dolën në krahë, dhe mbështetën luftën çlirimtare të popullit tonë, të UÇK-së, për ta çliruar këtë vend të dashur, këtë vend të vogël me këtë zemër kaq të madhe.

Sot e përherë përkulemi para dëshmoreve dhe dëshmorëve të atdheut tonë që ranë për lirinë tonë.

U jemi përjetë mirënjohës popujve miq, e qeverive të tyre që na mbështetën ngaherë e jo vetëm për këtë ditë. Para 25 vjetëve isha një vajzë e brishtë. Gjysmë e gjallë. Me zemër të thyer. Sepse nuk e kisha më pjesën më të madhe të familjes.

E sot...

E sot jam këtu para jush dhe bashkë me ju, ndjehem e privilegjuar dhe krenare që mund t'i shërbej popullit dhe vendit tonë.

Çdo 12 qershor e shënoj bashkë me ju fitoren e humanitetit përballë mizorisë.

Fitoren e të drejtës përballë padrejtësisë së gjatë. Fitoren e njerëzve të mirë e të guximshëm të Kosovës përballë aparatit gjenocidal. Dhe, fitoren e popujve të juaj që ishit pranë nesh për të na çliruar e për të na ndihmuar në këtë ditë.

Sot në këtë fjalë, në emër të grupit tonë të Lëvizjes, vendosa të ndajë pak nga personale. Besoj se kjo histori dhe këto kujtime i ndajmë gjithsecili në këtë ditë.

Lavdi dëshmorëve të atdheut!

Mirënjohje e përhershme për NATO-n! Mirënjohje e përhershme popujve miq të Kosovës! Faleminderit! Ju kërkoi ndjesë për emocionin, por ishte e pamundur! Ju faleminderit!

*(Duartrokitje)*

**KRYETARI:** Tash Partia Demokratike, fjalën ia japim kryetarit të kësaj, deputetit Memli Krasniqi.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit!

Më lejoni që fillimisht t'i them koleges sonë Saranda Bogujevci, emocionet tuaja janë emocione tona dhe forca jote ka qenë dhe është inspirim për secilin shqiptar që ka jetuar tmerrin e luftës sonë. Faleminderit, Sarandë!

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca,

I nderuar kryeministër, zoti Kurti,

Shumë i respektuar president i Shqipërisë, zoti Begaj,

E nderuar mike e Kosovës, kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, zonja Nikolla,

Shumë i respektuar Baca Rifat Jashari,  
Të respektuar mysafirë të nderuar, e miq të Kosovës, zoti Lord Robertson,  
Ish-president Mesiq,  
Ish-presidente e Zvicrës, Calmy-Rey,  
Miku i Kosovës, ambasadori Ulliam Voker,  
Ish-ministër Graniq,  
Shumë të respektuar ju mysafirë, ambasadorë, diplomatë, udhëheqës të institucioneve  
vendore e qendrore,  
Të dashur mysafirë,  
Të dashur qytetarë,  
Fillimisht dhe para së gjithash, urime 25-vjetori i Ditës së Çlirimit të Kosovës!

12 qershori i vitit 1999 është nga ato ditët që secili që e kemi jetuar e mbajmë në mend  
mirë se ku kemi qenë e çfarë kemi bërë atë ditë.

Dhe kjo ditë dikë e ka gjetur jashtë Kosovës, si të dëbuar dhunshëm apo nëpër kampe të  
refugjatëve, dikë në Kosovë, të frikësuar apo duke u strehuar nëpër male, dikë tjetër  
gjetiu degdisur nëpër shtete të ndryshme të botës e disa të tjerë edhe nëpër burgje të  
Serbisë.

Por, një kategori të zgjedhur të popullit tonë, kjo ditë i ka gjetur me pushkë në dorë, nëpër  
frontet e luftës çlirimtare, të gatshëm të vdesin për liri, duke ndjekur shembullin e  
pishtarit më të ndritshëm të rrugëtimit tonë kombëtar, të Komandantit Legjendar Adem  
Jashari.

Të nderuar kolegë,  
Meqë liria, para se gjithash, është vullneti për të qenë përgjegjës ndaj vetvetes, sot, më  
shumë sesa një fjalim të zakonshëm, e ndiej obligim të bëjë vetëm disa falënderime, të  
cilat, jo vetëm në këtë 25 vjetor të lirisë, por duhet t'i bëjmë përjetësisht, brez pas brezi e  
vit pas viti, për ata burra dhe ato gra, ato familje, të cilat patën vullnetin, guximin e  
besimin për të marrë përgjegjësi për vetveten, rrjedhimisht për të ardhmen e ndritshme të  
popullit dhe vendit tonë.

Të respektuara familje të dëshmorëve dhe të martirëve të luftës tonë çlirimtare - përlulje  
dhe nderim, që bijat dhe bijtë më të mirë ia falët kësaj toke, ia falët lirisë.

Është e pakët të thuhet ajo që dihet: se pa sakrificën dhe gjakun e tyre - asnjë nga ne nuk  
do të ishim sot këtu. E as Kosova nuk do të ishte e lirë!

Të nderuar veteranë dhe invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, faleminderit!

Faleminderit që pa menduar dy herë vutë jetën tuaj në rrezik - për një Kosovë pa robëri dhe një qiell pa re, duke i thyer kufijtë e ëndrrave të fëmijëve tanë.

Ju të burgosur politikë, intelektualë, gazetarë, publicistë, mësime dhënë, mjekë e infermierë, minorë, artistë, sportistë, fermerë, ndërmarrës, të gjithë ju qytetarë të devotshëm të Kosovës - faleminderit për qëndresën dhe kurajën e jashtëzakonshme që keni treguar vit pas viti, dekadë pas dekadë, duke qëndruar në këmbë edhe atëherë kur dorëzimi dukej si alternativa e vetme.

Secili në mënyrën tuaj, na keni frymëzuar dhe na keni mbajtur gjallë shpresën për ditën e madhe të lirisë.

Të dashur mërgimtarë,

Kemi qenë gjatë larg njëri-tjetrit, por më besoni se dashurinë, përkujdesjen, kontributin tuaj të pareshtur e kemi parë dhe ndjerë në secilën ditë të përpjekjeve tona për liri e shtet.

E ndjejmë edhe sot, dhe gëzohemi sa nuk thuhet që pas arritjes së lirisë - ju vazhdoni të na shtyni përpara drejt ambicieve të reja për ndërtimin dhe zhvillimin e shtetit tonë të përbashkët.

Prandaj, faleminderit nga zemra që nuk e harroni asnjëherë Kosovën!

Të dashur shqiptarë që jetoni kudo në Ballkan, në Maqedoni të Veriut, në Luginë të Preshevës, në Mal të Zi, faleminderit që ishit pranë nesh, si vëllezër dhe motra të një kombi e një gjaku, në momentet tona më të vështira.

Shumë e dashur Shqipëri, të dashur bashkëkombës, Kosova është e lirë sot, sepse ju ishit me ne dje.

Prandaj, tash e tutje, gjithmonë bashkë dhe asnjëherë më të ndarë drejt ëndrrave dhe arritjeve të reja.

Të nderuar miq dhe aleatë ndërkombëtarë,

Shtëpitë tona janë të Zotit dhe të Miqve!

Prandaj, ju jemi mirënjohës për mbështetjen e palëkundur në luftën tonë për liri dhe shtet e vlerësojmë me zëmër.

Faleminderit secilit ushtar, diplomat e aktivist për kontributin e tyre për lirinë tonë.

Kosova nuk harron. Asnjëherë!

Të dashur qytetarë,

Këto 25 vjet na kanë mësuar se Liria nuk është kurrë e garantuar dhe nuk mund të merret si e mirëqenë. Për të duhet luftuar dhe atë duhet mbrojtur çdo ditë. Për të duhet punuar ndershëm e me zell, që t'ua kalojmë brezave pasues si trashëgim.

E kush e di këtë gjë më mirë se sa ne këtu? Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe shokët e tyre në Hagë, që kanë thujse 4 dekada që luftojnë për liri dhe për mbrojtjen e saj.

Që nga protestat studentore e popullore në vitet e 80-ta, në celulat e para të krijimit të UÇK-së në fillimvitet e '90-ta, në luftën e tyre çlirimtare në fundvitet e '90-ta, në përpjekjet e jashtëzakonshme për pavarësi në dekadën e parë të këtij mijëvjecari, lufta e tyre nuk u ndal kurrë.

Sot, jemi në vitin 2024, tashmë ata janë burra të thinjur, ndërsa beteja e tyre për lirinë tonë po vazhdon ende.

Këta burra janë testament i gjallë i sakrificave dhe përpjekjeve të pandalshme që kërkon liria dhe shteti.

E dimë dhe jemi të bindur që shumë shpejt ata do t'i kemi në mesin tonë, prandaj, sot, në këtë ditë të shënuar, për të cilën secili prej tyre ka kontribuar shumë, u dërgojmë urimet dhe të falat tona e të mbarë popullit të Kosovës.

Ju themi se ju jeni heronj të luftës dhe të paqes dhe se askush me asgjë nuk mund ta ndryshojë këtë të vërtetë. Qëndroni të fortë sepse, pa dyshim, dielli do të lind përsëri. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Tash në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari i këtij Grupi Parlamentar, deputeti Arben Gashi e merr fjalën.

**ARBEN GASHI:** Të nderuar mysafir dhe të ftuar,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, përkujtojmë dhe respektojmë një nga momentet më të rëndësishme dhe me krenare në historinë tonë të re, Ditën e Çlirimit të Kosovës.

Kjo ditë shënon 25-vjetorin e largimit të forcave pushtuese serbe dhe fillimin e një kapitulli të ri për popullin tonë të lirë dhe të pavarur.

Çerek shekulli më parë, populli ynë jetonte në kushtet më të rënda të përndjekjes, diskriminimit dhe masakrave. E gjithë bota u trondit nga pamjet e dhunës së papërshkrueshme që përjetuan shqiptarët e Kosovës. Por, as në momentet më të vështira ne nuk e humbëm shpirtin tonë luftarak dhe dëshirën e pashuar për liri, pavarësi, dhe demokraci.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me guxim dhe sakrificë të pashoqe, luftoi për të drejtat dhe lirinë tonë, duke i treguar botës se populli shqiptar nuk do të nënshtrohej kurrë.

Ne këto rrethana dhe zhvillime, ndërhyrja e NATO-s, e cila erdhi me vendosmëri për të ndaluar gjenocidin dhe për të mbrojtur popullin tonë, ishte jetike për arritjen e qëllimit tonë të shenjtë për liri, demokraci dhe pavarësi.

Në këtë ditë të shenjtë, përulemi me respekt të thellë para të gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë tonë. Të rinjtë dhe të rejtat e Kosovës, që luftuan me zemër dhe shpirt për një të ardhme të lirë dhe demokratike janë heronjtë tanë të përjetshëm. Kujtimi dhe sakrificat e tyre na obligon që të punojmë pa u lodhur për ndërtimin e një shteti që respekton dhe mbron të drejtat e të gjithë qytetarëve të tij.

Në këtë rrugëtim të gjatë drejt lirisë, një rol të jashtëzakonshëm ka luajtur edhe rezistenca jonë antikomuniste, e cila filloi shumë kohë para luftës së fundit. Ky ishte një kapitull i rëndësishëm në historinë tonë, ku shumë burra dhe gra të guximshme sfiduan regjimin e egër komunist në përpjekje për liri dhe drejtësi. Ata hodhën themelet e rezistencës që më vonë do të shndërrohej në luftën për çlirim.

Presidenti historik i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova me vizionin e tij për pavarësi dhe me qasjen e tij diplomatike, ndërtoi ura të rëndësishme me komunitetin ndërkombëtar dhe udhëhoqi popullin tonë nëpër një periudhë të trazuar.

Ibrahim Rugova u bë simboli i shtetit dhe një inspirim për brezat e ardhshëm, duke na kujtuar se qëllimi për liri dhe pavarësia arrihen me mençuri partneritet ndërkombëtar dhe dialog. Por, edhe me parapërgatitje për luftën final për çlirim.

Gjatë viteve të errëta të shtypjes, populli ynë nuk reshti kurrë së rezistuari. Nga aktivistë të palodhur të rezistencës paqësore e lëvizjes qytetare, u bënë luftëtarë të guximshëm të UÇK-së, dhe të gjithë së bashku kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ky qëndrim i patundur është shembulli më i mirë i shpirtit të palëkundur të kombit tonë. Ne jemi një popull që nuk dorëzohet kurrë, një popull që qëndron i bashkuar përballë çdo sfide dhe që di të mbrojë të drejtat e tij me krenari dhe dinjitet.



Por, ndërsa festojmë këtë përvjetor, duhet të kujtojmë se sfidat nuk kanë përfunduar. Ndërtimi i një shoqërie të drejtë dhe prosperuese kërkon angazhimin dhe përkushtimin tonë të vazhdueshëm. Ne duhet të punojmë për forcimin e institucioneve demokratike, përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë dhe për të siguruar një të ardhme të ndritur për brezat që vijnë. Ky është një mision i përbashkët që kërkon bashkërendim dhe përkushtim nga të gjithë ne.

Sot, ne nuk përkujtojmë vetëm një ngjarje historike, por ripërtërijmë betimin tonë për të ruajtur dhe përparuar atë që është arritur me kaq shumë sakrificë. Le të jemi krenarë për të kaluarën tonë, të përgjegjshëm për të tashmen dhe të angazhuar për të ardhmen e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Sepse vetëm kështu, me unitet dhe përkushtim, do të sigurojmë që Kosova të jetë gjithmonë një tokë e lirë, e pavarur dhe krenare.

Në këtë përvjetor të 25-të të çlirimit të Kosovës, le të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi për të ardhmen. Ndërtimi i një shoqërie të drejtë, demokratike dhe të begatë është një proces i vazhdueshëm që kërkon përkushtim dhe angazhim të përhershëm. Ne duhet të punojmë për të siguruar që çdo qytetar i Kosovës të ketë mundësinë për të jetuar një jetë të denjë dhe të sigurt në vendin e tij.

Le të angazhohemi për të ndërtuar një Kosovë ku sundon ligji dhe drejtësia, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe mbrohen, dhe ku çdo qytetar ka mundësinë për të realizuar potencialin e tij të plotë. Kjo është detyra jonë dhe amaneti që na kanë lënë ata që luftuan dhe sakrifkuan për lirinë tonë. Zoti e bekoftë Kosovën! Zoti i bekoftë qytetarët e saj! Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash Grupi i AAK-së. Kryetari i këtij grupi, flet deputeti Besnik Tahiri.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, i nderuar kryetar Glauk Konjufca!

Më lejoni që fillimisht edhe unë t'i bashkohemi kësaj feste dhe të them që emocionin që na e përçoi Saranda sot, është një emocion që na forcon, e na bën optimistë se Kosovën do ta rritim.

I nderuar kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca,

I nderuar kryeministër Albin Kurti,

I nderuar president Bajram Begaj mirë se ke ardhur. Faleminderit për kohën tuaj!

E nderuar kryetare e Kuvendit, Lindita Nikolla mirë se ke ardhur!

I dashur baca Rifat faleminderit që je me ne! Sa herë që të kemi përballë na jep motiv që të jemi më të përgjegjshëm në detyrat tona.

Familjarë të dëshmorëve,

Veteranë dhe invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, respekt dhe faleminderit për angazhimin tuaj!

President Mesiq mirë se ke ardhur! Faleminderit që je me ne!

Presidentja Kalmi Rei, Thank you for being with us!

Shumë i dashur ambasador Ulliam Uoker, shefi im i parë në OSBE. Great to see you here! Thank you for your servise!

Të dashur ambasadorë të vendeve mike,

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Italisë dhe të gjithë ju që jeni sot prezentë,

President Sejdiu,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

25 vjet më parë, ka ndodhur mrekullia në këtë vend. Pas shekujsh përpjekjesh e betejash, pas mijëra e mijëra shqiptarëve të vrarë, të burgosur e të syrgjynosur, Kosova dhe qytetarët e saj, më në fund u çliruan. Pra, ishim të lirë. Kosova dhe qytetarët e saj përjetë do të kujtojnë këtë datë që padyshim është data më e rëndësishme në historinë tonë.

E kemi për detyrë të përulemi t'u përulemi të gjithë atyre dëshmorëve e heronjve që ndër breza, duke filluar nga Adem Jashari, Shkëlzen e Luan Haradinaj, Zahir Pajaziti, Sali Çeku e Agim Ramadani që luftuan për lirinë që e gëzojmë sot. E kemi për obligim t'i kujtojmë edhe gjithë ata luftëtarë trima të UÇK-së, të rënë në betejat e tyre, por edhe këta që janë gjallë, që ia kthyen pushkën regjimit më të egër, pushtetit i cili deshi të na shfarojë.

Padyshim duhet kujtuar edhe mijëra veprimtarë nëpër fusha të ndryshme. Të përkujtojmë Adem Demaçin me shokët e tij që ishin të burgosur politikë, e në etapa të ndryshme të historisë sonë e vendosën nga një gurë në kalanë e lirisë dhe më në fund të shtetit të pavarur të Kosovës. Kujtojmë kontributin e pamohuar të gjithë atyre nga lëvizjet e hershme kombëtare e deri tek lëvizja pacifiste e presidentit Ibrahim Rugova.

Po ashtu në këtë s'kemi pse të mos themi që Kosovës po i mungojnë edhe udhëheqë që janë gjallë e që ishin protagonistë të luftës, të paqes e të pavarësisë së Kosovës, presidentin Thaçi, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, gjeneral Rexhep Selimi dhe të tjerët të cilët kanë dhënë një kontribut të madh në luftën e drejtë për liri, e shpresoj e besoj që drejtësia do të triumfojë edhe për ta.

Mirënjohje e përjetshme Aleatëve tanë. Po e nis me Lordin Robertson, thank you very much për krejt punën që keni bërë me sulmet e NATO-s në Kosovë!

Falënderojmë të gjitha shtetet mire që janë me ne në çdo rrugëtim tonë dhe na kanë ndihmuar në çlirim e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Kosova sot është një shtet i ri dhe ka bërë përpjekje titanike të vendosë bazat e një demokracie funksionale. Na kujtohet të gjithëve që nga një vend pothuajse i shkatërruar tërësisht, së bashku kemi arritur të bëhemi shtet funksional, me një Kushtetutë të avancuar që i mbron të drejtat e njeriut. Që njeh konceptin multietnik në një shoqëri ku 95% janë shqiptarë.

Ne jemi krenarë me sistemin e ndërtuar të sigurisë sonë. Me policët tanë. Me ushtarët tanë dhe me të gjithë ata që i shërbejnë me devotshmëri mbrojtjes së vendit tonë. Ne jemi krenarë me sistemin e admirueshëm të drejtësisë, me demokraci parlamentare, me zgjedhje të lira e demokratike që nga viti 2000 e deri tek diveristetit që është në shoqërinë tonë, e që i jep një shkëlqim Republikës së Kosovës.

Pyetja shtrohet: a ka mundur të bëhet më mirë. Sigurisht se po. Por, a ka vend për nihilizëm? Natyrisht se jo. Ka disa zëra që thonë se ky vend u shkatërrua për 20 vjet, por e vërteta është krejt ndryshe, ky vend u ndërtua nga asgjëja, e hiri. Ky vend ishte i shkatërruar dhe këtë hir e lanë pushtuesit. Sot Kosova është e barabartë me vendet që kanë traditë mbi 100-vjeçare shtetërore. Sot, Kosova është e lirë dhe shtëpi e të gjithë ve, pa dallim.

Sot po ashtu duhet të thuhet zëshëm se pavarësisht sukseseve të mëdha, ne kemi ende ka sfida, e të cilat, thënë të drejtën, nuk janë aspak të lehta. Drejt konsolidimit të plotë të shtetësisë sfidat, por edhe përpjekjet kryesore që na dalin përpara mbesin: forcimi i shteti ligjor.

Të punojmë së bashku për anëtarësimin e Kosovës në NATO, në Këshillin e Evropës, në BE dhe në Kombet e Bashkuara. Natyrisht edhe përmbyllja e marrëveshjes për njohje të ndërsjellë me Serbinë.

Për këto qëllime, të nderuar deputetë, duhet të kemi unitet e të punojmë bashkë, por duhet të punojmë bashkë edhe me aleatët tanë. Të gjitha këto nuk arrihen pa partneritet të fortë me aleatët perëndimorë, para së gjithash me shtetet e SHBA-së dhe BE-së.

Nuk duhet kurrë të harrohet se Kosova, sot një ndër vlerat e veta të pakontestueshme dhe më të mëdha i ka aleancat, duhet mbështetur ato, duke kultivuar këtë miqësi pa ekuivokë. Këto aleanca duhet t'i mbrojmë, duke respektuar fjalën dhe duke i mbajtur marrëveshjet e dakorduara.

Të qytetarë të Republikës së Kosovës

Liria ka emër dhe ai emër është Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila u ndihmua nga NATO-ja, dhe sot 25 vjet më vonë jemi bashkë të lirë në një shtet që pretendon të jetë i barabartë me të gjitha vendet evropiane. Më 2 qershor, 25 vjet më herët, unë kam hyrë në Kosovë, bashkë me trupat britanike.

Sot me mua këtu është koloneli Kris Uoren, me të cilin kam hyrë me helikopter në atë kohë në Kosovë. Ishin emocione të forta, emocione ku shiheshin që largohen trupat pushtues dhe emocione duke i parë qytetarët e Kosovës të cilët i gëzoheshin lirisë.

Nga ky Kuvend, shpreh respektin e falënderimin për të gjithë ata ushtarë të UÇK-së e trupave paqeruajtëse të NATO-s që sot qytetarët e gëzojnë lirinë në Kosovën shtet të pavarur e demokratik.

Faleminderit UÇK-së,  
Thank You NATO!

**KRYETARI:** Tash ia japim fjalën kryetarit të Grupit Multietnik, aty ku përfaqësohen në këtë grup parlamentar komunitetet tona joshumicë që i kemi në Kosovë. Urdhëro, zoti Kervan!

**ENIS KERVAN:** Faleminderit kryetar Konjufca,

I nderuari kryeministër Kurti,

I nderuari president Begaj,

E nderuar kryetare zonja Nikolla,

I nderuari Baca Rifat,

Të nderuar ambasadorë,

Familjarë të dëshmorëve,

Të nderuar të pranishëm,

Qytetarë të Kosovës,

Sot, në këtë moment historik të rëndësishëm në historinë e shtetit tonë - 25 vjet nga çlirimi i Kosovës.

Duke reflektuar në këtë rrugëtim, në mënyrë të padiskutueshme, para së gjithash, nderojmë sakrificën e thellë të trimëreshave dhe trimave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Guximi dhe shpirti i paepur i tyre na kanë sjellë vlerat më të çmuara të lirisë, të paqes dhe mundësisë për ta ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Si kryetar i Grupit parlamentar Multietnik, në emër të komuniteteve turk, boshnjak, ashkali, rom dhe egjiptian flas me mirënjohje dhe krenari të thellë për mbërritjet dhe progresin e përgjithshëm në Kosovë.

Rrugëtimi ynë drejt një shteti të fortë demokratik është angazhim i të gjithë spektrit politik e shoqëror, të përkushtuar ndaj barazisë dhe angazhimit të qartë dhe të palëkundur për një shoqëri barazimtare për të gjithë.

Sot, në këtë moment historik, me krenari dëshmoj se ne, pjesëtarët e komuniteteve joshumicë nuk jemi vetëm pjesëmarrës, por partnerë të barabartë në shtetndërtim.

Ne sot gëzojmë të gjitha të drejtat dhe mundësitë kushtetuese, duke ecur së bashku krah për krah drejt një të ardhmeje të përbashkët.

Institucionet e Republikës së Kosovës, janë të qëndrueshme sepse pasqyrojnë, në mënyrë të qartë, mozaikun e shoqërisë sonë.

Kjo forcë kolektive është një dëshmi e vizionit të një Kosove gjithëpërfshirëse, ku zëri dhe bindjet e pjesëtarëve të secilit komunitet dëgjohen, respektohen dhe adresohen.

Më 12 qershor të vitit 1999 NATO-ja filloi operacionin e vendosjes së trupave paqeruajtëse në Kosovë.

Prandaj, në këtë moment historik, zonja dhe zotërinj - i detyrohemi një mirënjohjeje të madhe miqve tanë të shumtë ndërkombëtarë për rolin e tyre vendimtar në çlirimin e Kosovës, dhe mbështetjen e tyre të patundur në rrugëtimin tonë të ndërtimit të shtetit.

Kontributet e miqve tanë ndërkombëtarë kanë qenë ekskluzivisht të rëndësishëm në ngritjen dhe formësimin e institucioneve të Republikës, forcimin e demokracisë dhe hapjen e rrugës drejt integritit në strukturat evropiane dhe euroatlantike. Udhëzimet e përhershme dhe mbështetja e aleatëve tanë ndërkombëtarë kanë qenë e paçmueshme, dhe për këtë, ne shprehim falënderimet tona të përzemërta.

Sot, ne festojmë jo vetëm një çerek shekulli të çlirimit, por edhe 25 vjet rritje, unitet dhe përparim.

Ne, gjithsesi, nderojmë trashëgiminë e atyre që luftuan për lirinë tonë duke u siguruar që Kosova dhe institucionet e saj, shoqëria kosovare në përgjithësi, të jenë garant i demokracisë, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes.

Së bashku, ne kemi ndërtuar një shoqëri ku barazia nuk është një aspiratë, por një realitet, dhe ku çdo individ, pavarësisht nga përkatësia etnike mund të avancojë dhe të mbërrijë.

Prandaj, e përkujtoj veçanërisht gjeneralin Adem Jashari, dhe gjithë dëshmorët që e bënë atdheun tonë të pavarur, e përkujtoj me respekt Presidentin Rugova, e përshëndes edhe të gjithë liderët partiakë dhe të gjithë, të cilët kanë kontribuar pa und për arritjen e këtyre ditëve.

Sot edhe një herë nga kjo foltore, në këtë moment historik, riafirmojmë përkushtimin tonë për një Kosovë ku secili qytetar, nga të gjitha komunitet, ecën përpara së bashku më të fortë, më të bashkuar dhe me shpresë e dinjitet. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Duke ju falënderuar të gjithëve që morët pjesë në këtë seancë të rëndësishme solemne, të gjithë së bashku po ua urojmë qytetarëve tanë Ditën e çlirimit, 25-vjetorin e çlirimit të Republikës sonë. Ju faleminderit e mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*